



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipality Kacanik

01 Nr. 16-11613/16
Kaçanik, 04.05/2016

Në bazë të nenit 51.2. të Ligjit Nr. 03/L-040 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008) të nenit 47 të Statutit të Komunës, si dhe nenit 48 të Rregullores për Punë të Kuvendit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 30.03.2016, mori këtë:

VENDIM
PËR ZËVËNDËSIMIN E NJË ANËTARI NË KOMITETIN PËR SHËRBIME
PUBLIKE

1. Me këtë Vendim, Lebibe Bela, caktohet anëtare në Komitetin për Shërbime Publike, në vend të, Avni Tafili, i cili është caktuar anëtar në Komitetin për Politikë dhe Financa.
2. Caktimi i anëtares si në pikën 1. të këtij Vendimi, bëhet pasi anëtari i mëparshëm, Avni Tafili, ka kaluar në një detyrë tjetër.
3. Mandati i anëtares nga pika 1. e këtij Vendimi është i lidhur me mandatin e Komitetit për Shërbime Publike, ndërsa fillon nga dita e caktimit të saj në këtë komitet.
4. Anëtarja e përcaktuar si në pikën 1. të këtij Vendimi do t'i ushtroj të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë e përcaktuara si në dispozitat ligjore që e rregullojnë çështjen e Komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Lebibe Bela, Avni Tafili, Kryetari i Komunës, Komiteti për Shërbime Publike, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi